

Ekspozimi dhe perceptimi i studentëve shqiptarë ndaj dezinformimit

Autor: Gevio Tabaku, [PortaliStudentor.al](https://portalistudentor.al) | Janar 2026

1. HYRJE

Në dekadën e fundit, peizazhi informativ në Shqipëri ka pësuar një transformim të qënësishëm. Kalimi nga mediat tradicionale drejt platformave sociale të decentralizuara ka demokratizuar informacionin, por gjithashtu ka hapur portat për një "infodemi" të pakontrolluar. Për brezin e ri, kufiri midis informimit, argëtimit dhe manipulimit është bërë gjithnjë e më i paqartë.

Dezinformimi nuk është më thjesht një çështje e lajmeve të rreme politike; ai është një fenomen kompleks që përfshin propagandën, përmbajtjen e manipuluar nga AI (Deepfakes) dhe fushatat e orkestruara nga "trolls". Në kontekstin shqiptar, ku shkalla e penetrimit të internetit është e lartë por kurrikulat e edukimit mediatik në shkolla janë ende në zhvillim, studentët gjenden në vijën e parë të këtij sulmi.

Qëllimi i këtij raporti është të diagnostikojë gjendjen aktuale të ekspozimit dhe perceptimit të studentëve shqiptarë ndaj dezinformimit. Përmes analizës së të dhënave, ne synojmë të kuptojmë jo vetëm sa kohë shpenzojnë ata online, por si e procesojnë informacionin e dyshimtë dhe ku ata kanë mangësi.

2. METODOLOGJIA

Të dhënat e prezantuara në këtë raport bazohen në një studim sasior të kryer në Janar 2026.

- **Kampioni:** Studimi përfshiu 686 studentë shqiptarë, duke ofruar një bazë përfaqësuese të rinisë universitare në vend.
- **Instrumenti:** Mbledhja e të dhënave u realizua përmes një pyetësoi të strukturuar online, i dizajnuar për të matur katër dimensione kryesore: zakonet e përdorimit të medias, njohuritë teorike, vetë-vlerësimin e aftësive dhe sjelljen reale.
- **Kufizimet:** Si çdo studim i bazuar në vetë-raportim (self-reporting), ekziston mundësia e anshmërisë në përgjigjet që lidhen me aftësitë personale, fenomen i njohur si efekti Dunning-Kruger.


3. GJETJET E STUDIMIT

Analiza e të dhënave ka nxjerrë në pah shtatë gjetje kryesore që formësojnë profilin digjital të studentit shqiptar sot.


3.1. Ekspozimi Masiv dhe Dominimi i "Fast-Media"

Studentët shqiptarë jetojnë në një mjedis të saturimit digjital. Të dhënat tregojnë se 56% e të anketuarve shpenzojnë më shumë se 3 orë në ditë në rrjetet sociale. Ky nuk është thjesht konsum; është një stil jetese.

Më e rëndësishme se sasia e kohës është natyra e platformave të përdorura. TikTok dominon me 47% të përdoruesve, i ndjekur nga Instagram me 44%. Kjo tregon një zhvendosje drejt përmbajtjes vizuale, të shkurtër dhe algoritmike.



[FIGURA 1: Orët ditore në rrjete sociale – Grafiku tregon ndarjen e kohës së shpenzuar]




[FIGURA 2: Platformat kryesore – Krahاسimi midis TikTok, Instagram dhe platformave të tjera]

Dominimi i TikTok-ut është kritik për analizën e dezinformimit, pasi arkitektura e këtij aplikacioni favorizon shpejtësinë dhe emocionalitetin mbi verifikimin dhe kontekstin.

3.2. Një boshllëk në termin “Dizinformim”


Pavarësisht ekspozimit të lartë, njohuritë e studentëve mbeten të lëkundura. Edhe pse 57% e studentëve e njohin termin "dezinformim", një pjesë e konsiderueshme prej 43% ose nuk e kanë dëgjuar kurrë, ose e ngatërrojnë me terma të tjerë. Kjo sugjeron se shumë studentë mund të jenë duke tentuar të luftojnë me një armik që nuk i vënë dot as emrin.



[FIGURA 3: Njohuria e termit - Njohja e konceptit "dezinformim"]

3.3. Aftësia e tyre për të identifikuar lajmet e rreme

Kur u pyetën për aftësinë e tyre për të identifikuar lajmet e rreme, studentët e vlerësuan veten me një mesatare prej 3.49 nga 5. Ky rezultat tregon një besim të moderuar - ata as nuk ndihen të paditur, por as ekspertë. Megjithatë, siç do ta shohim në gjetjen tjetër, ky besim shpesh nuk përputhet me realitetin.




[FIGURA 4: Vetë-vlerësimi – Shpërndarja e pikëve nga 1 tek 5]


3.4. Rreziku i shpërndarjes së paqëllimshme të dezinformimit

Kjo është gjetja më e rëndësishme e pyetësorit. Pavarësisht se e konsiderojnë veten relativisht të aftë, 48.3% e studentëve pranojnë se kanë shpërndarë lajme të rreme pa e ditur se ishin të tilla. Kjo shifër alarmante tregon se mekanizmat e verifikimit dështojnë në momentin e impulsit për të shpërndarë në rrjete sociale mes miqsh.

Për më tepër, reagimi ndaj përmbajtjes së dyshimtë është pasiv. Reagimi më i zakonshëm (262 studentë) është: "E injoroj dhe vazhdoj". Ndërsa injorimi mbron individin, ai nuk ndihmon në pastrimin e ekosistemit informativ, duke lënë dezinformimin të qarkullojë lirisht për të tjerët.




[FIGURA 5: Shpërndarja e lajmeve të rreme - Përqindja e atyre që kanë shpërndarë pa dashje]



[FIGURA 6: Reagimi ndaj përmbajtjes së dyshimtë – Krahasimi midis injorimit, raportimit dhe verifikimit]

3.5. AI vs. Bots

Ekziston një disbalancë interesante në njohuritë teknike. 90% e studentëve janë të vetëdijshëm për Deepfakes dhe Inteligjencën Artificiale, ndoshta për shkak të mbulimit të gjerë mediatik dhe trendeve në TikTok. Nga ana tjetër, vetëm 47.5% kanë njohuri për "trolls" dhe "bots". Ky është një boshllëk i rrezikshëm, pasi "bots" (llogaritë e automatizuara) janë shpesh motorët kryesorë që amplifikojnë dezinformimin para se ai të bëhet viral.




[FIGURA 7: Njohuritë teknike - Krahasimi i njohurive për Deepfakes vs Trolls/Bots]

3.6. Perceptimi i Rrezikut

Përtej analizës së sjelljes në platforma specifike, studimi mati perceptimin e përgjithshëm të studentëve ndaj fenomenit të dezinformimit. Rezultatet tregojnë një ndërgjegjësim të lartë lidhur me kërcënimin që lajmet e rreme paraqesin për shoqërinë.

Në një shkallë nga 1 (aspak e rrezikshme) deri në 5 (shumë e rrezikshme), studentët e vlerësuan rrezikshmërinë e dezinformimit me një mesatare të ponderuar prej **4.56 nga 5**. Kjo tregon se, pavarësisht vështirësive në identifikimin e lajmeve të rreme ose tendencës për t'i shpërndarë ato pa verifikim, studentët janë plotësisht të vetëdijshëm për peshën e problemit. Ata e konsiderojnë dezinformimin si një çështje kritike që kërkon vëmendje, gjë që sugjeron se mungesa e verifikimit nuk vjen nga neglizhimi i rrezikut, por nga faktorë të tjerë (si mungesa e aftësive ose natyra e platformave).




[FIGURA 8: Perceptimi i rrezikshmërisë së dezinformimit]

3.7. Mundësi për edukimin e tyre

Një nga gjetjet më inkurajuese të këtij studimi lidhet me gatishmërinë e studentëve për të përmirësuar aftësitë e tyre në shkrim-leximin mediatik. Të dhënat tregojnë se **58% e të anketuarve** u shprehën pozitivisht për dëshirën e tyre për të konsumuar përmbajtje edukative specifike mbi dezinformimin.

Interesi i lartë sugjeron se studentët nuk janë pasivë ndaj problemit; ata kërkojnë mjete dhe njohuri për të naviguar më mirë në ekosistemin digjital. Kjo "uri" për edukim verifikon nevojën për ndërhyrje dhe rrit shanset për suksesin e iniciativave edukative, me kusht që ato të jenë të formatuara në mënyrë tërheqëse dhe të përshtatshme për zakonet e tyre të konsumit mediatik.



[FIGURA 9: Interesi i studentëve për materiale edukative mbi dezinformimin]

4. REKOMANDIMET

Bazuar në gjetjet e studimit dhe diskutimin e mësipërm, propozohen rekomandimet e mëposhtme strategjike për të adresuar problemin e dezinformimit të studentët:

1. **Edukim me stil TikTok-u**

Materialet edukative nuk duhet të jenë leksione të gjata tradicionale. Ato duhet të përshtaten me formatin që studentët konsumojnë më shumë: video të shkurtra, vizuale dhe dinamike (short-form content). Edukimi i ri duhet të flasë "gjuhën" e algoritmeve që përdorin studentët.

2. **Fushata 'Ndalo & Verifiko'**

Nevojitet një fushatë ndërgjegjësuere që synon të frenojë shpërndarjen e pamenduar të postimeve, qofshin këto dizinformuese ose jo. Qëllimi është të inkurajohet një moment reflektimi midis konsumimit të informacionit dhe reagimit ndaj tij.

3. **Trajnim praktik, jo vetëm teorik**

Edukimi duhet të fokusohet në aftësi konkrete, si përdorimi i mjeteve për verifikimin e

fotove (reverse image search) dhe identifikimin e burimeve primare, duke kaluar nga rreziku në teori, në mbrojtje në praktikë.

4. Edukim specifik për Trolls dhe Bots

Duke marrë parasysh boshllëkun e njohurive prej 52% në identifikimin e llogarive të automatizuara dhe dashakeqe, kurrikulat shkollore duhet të kenë module të veçanta që shpjegojnë anatominë e një profili të rremë dhe sjelljen e koordinuar jo origjinale.

5. Integrim në kurrikulën e universiteteve

Për një zgjidhje afatgjatë, universitetet duhet të integrojnë modulet e shkrim-leximit mediatik si pjesë themelore e programeve të studimit, pavarësisht degës, duke e trajtuar atë si një kompetencë thelbësore qytetare.